

POLICY BRIEF

Kostoja e Korrupsionit në Shqipëri 2025

Model i ri dinamik — 3 shtylla — Llogaritje, Pasoja dhe Rekomandime

AO-RES-26-003

Maj 2026

5 faqe

MESAZHET KRYESORE

€852 mln – €1.115 miliardë / 3.1–4.0% e PBB - Kjo është kostoja totale e korrupsionit në 2025

Kostoja totale e korrupsionit përbëhet nga *kostoja direkte fiskale* (€650–810 mln) plus *humbja indirekte* nga ngadalësimi i rritjes ekonomike (€202–305 mln).

Rritja ekonomike ulet 0.73–1.10 pikë përqindjeje në vit

Çdo pikë rritje e humbur i kushton vendit €200–300 mln prodhim vjetor të parealizuar. Efekti kumulativ 2025–2030 është €3.7–5.7 miliardë humbje potenciale GDP.

22–29% e buxhetit social nuk arrin te qytetari

Indeksi i Mirëqenies së Humbur (IMH ≈ 26.2%) nga €3.75 mld shpenzimeve sociale, €850 mln–€1.1 mld humbin efektivitetin nga korrupsioni sistematik. Kjo tregon se 1 nga 4 lekë në arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale nuk arrin te qytetari.

EU CPI 39/100 — 25 pikë nën mesataren e BE (64)

Shqipëria në 2025 renditet e fundit midis vendeve kandidate me progres të ngadaltë. Çdo 10 pikë rritje CPI ka potencial të sjellë shtesë +0.3–0.5 pp rritje dhe +5–8% FDI neto.

01

Konteksti dhe Qëllimi

Pse një model i ri matjeje?

Shqipëria vuan nga korrupsion sistematik i vlerësuar ndër më të lartët në rajon (CPI = 39/100). **Ky raport ALTAX prezanton modelin e parë dinamik shqiptar të matjes së kostos reale ekonomike dhe jo vetëm perceptimin, por humbjen e verifikuar e të llogaritshme sipas metodologjisë përkatëse.**

Modeli ndahet në tre shtylla të pavarura: **(A) Kosto Direkte Fiskale** — humbja nga abuzimi i drejtpërdrejtë me fondet publike; **(B) Kosto Indirekte Ekonomike** — ngadalësimi i rritjes GDP; **(C) Indeksi i Mirëqenies së Humbur (IMH)** — humbja e efektivitetit të shpenzimeve sociale.




Figura 1 | Shqipëria (CPI 39) renditet 25 pikë nën mesataren e BE dhe prapa shumicës së vendeve WB6 | Burimi: TI CPI 2025

02

Metodologjia — 3 Shtylla

Formula dhe parametrat e modelit

Shtylla	Formula	Parametrat dhe Rezultati
Shtylla A Kosto Direkte	$G \times r$	$G = \text{€}8.30 \text{ mld shpenzime publike} \cdot r = 8\text{--}10\% \rightarrow \text{€}650\text{--}810 \text{ mln}$
Shtylla B Kosto Indirekte	$\beta \times (100 - \text{CPI}) \times \text{GDP}$	$\beta = 0.012\text{--}0.018 \cdot \text{CPI} = 39 \cdot \text{GDP} = \text{€}27.7 \text{ mld} \rightarrow \Delta \text{rritje } 0.73\text{--}1.10 \text{ pp} \rightarrow \text{€}202\text{--}305 \text{ mln}$
Shtylla C Indeksi IMH	$\text{Kosto Totale} / \text{Shpenz. Sociale} \times 100$	$\text{Shpenz. sociale+arsim+shëndetësi} = \text{€}3.75 \text{ mld} \rightarrow \text{IMH} = 22\text{--}29\% \text{ (mesatare } 26\%)$
TOTALI	$A + B$	$\text{€}852\text{--}1,115 \text{ mln} \cdot 3.1\text{--}4.0\% \text{ e PBB-së}$

Burimi i ndjeshmërisë kryesore: **koeficienti β (0.012–0.018)** derivuar nga IMF (2016) SDN/16/05 dhe Ugur & Dasgupta (2011), i kalibruar për kontekstin e lartë informalitetit shqiptar. Ndryshimi ± 0.003 prodhon variancë $\pm \text{€}60 \text{ mln}$, model robust.

03

Rezultatet Kryesore — 4 Kartela

Shifra të verifikuara dhe të krahasueshme

€983 mln mesatare 2025

Kosto totale e verifikuar

Shtylla A (direkte) + B (indirekte). Intervali i plotë: €852 mln – €1.115 mld sipas parametrave β dhe r.

26.2% IMH mesatar

Humbje efektiviteti social

€983 mln / €3.75 mld shpenzimeve sociale = 26.2% i përealizuar. Interval: 22–29%.

0.73–1.10 pp humbje rritjeje

Impakti mbi rritjen vjetore

$\beta \times (100-39) \times \text{GDP}$: Çdo vit ekonomia humbet 0.73–1.10 pikë rritjeje nga korrupsioni sistematik.

+€1.24 mld deri 2030

Fitim nëse CPI shkon 39→52

Diferenca kumulative GDP midis skenarit bazë (3.7%) dhe skenarit pa korrupsion (4.5%) deri 2030.

Kostoja Totale e Korrupsionit 2025




Figura 2 | Kosto totale: €983 mln mesatare (€852–1,115 mln). Skenari Optimist ulë koston me €221 mln/vit | Burimi: Llogaritje ALTAX 2025

Projeksionet e PBB-së 2025-2030: Çfarë humbet nga korrupsioni




Figura 3 | Nëse CPI shkon 39→52 deri 2030 (rritje 4.5%/vit), GDP 2030 = €34.4 mld vs €33.2 mld (diferenca €1.2 mld) | Burimi: IMF WEO 2025 + model ALTAX

Nëse korrupsioni ulet 25–30% duke çuar CPI nga 39 në 52, atëherë vendi fiton €4–7 miliardë GDP shtesë kumulative deri 2030 dhe ulet kostoja vjetore me €220 mln. Ky është kthimi i investimit në reformë institucionale.

04

5 Rekomandime me Afat dhe KPI

Veprime konkrete të prioritizuara sipas impaktit fiskal

#	Afati	Masa / Reforma	Impakti Fiskal	KPI Monitorimi
01	Dhjetor 2026	Dixhitalizim i plotë i Prokurimeve Publike (E-Procurement)	€200–350 mln/vit	Prokurime elektronike >80%; fryrja e kontratave <5%
02	Qershor 2026	Forcimi i SPAK: buxhet +40%, 50 prokurorë të rinj, laborator dixhital forensik	€100–200 mln/vit	Çështje të ndjekkura +30%/vit; dënime >60%
03	Buxheti 2027	Raportim publik vjetor i Kostos së Korrupsionit — transparencë institucionale	Legjitimitet +CPI	CPI +3–5 pikë brenda 2 viteve; raport vjetor publik
04	Qershor 2027	Dixhitalizim fiskal: zgjerim fiskalizimit, auditim automatik, ndërveprim tatimor	€80–140 mln/vit	Evazion tatimor <0.4% GDP (nga 0.5%); TAP-et +15%
05	2030	Target kombëtar CPI 50–55 — Plan veprimi i integruar në Kap. 23 të negociatave BE	+€3.7 mld GDP	CPI 2030 ≥ 50 • IMH <20% • Raporti EBRD "lider"

BCR (Benefit-Cost Ratio): Çdo €1 investim në E-Procurement sjell €45 kursim (BCR 1:45). Monitorimi i pavarur ka BCR 1:150 — masa me kosto minimale dhe impakt maksimal.

05

Konteksti i Politikave dhe Integrimi Europian

Lidhja me Kapitullin 23 — antikorrupsion

Progresi i Shqipërisë drejt BE-së varet drejtpërdrejt nga reformat antikorrupsion. Kapitulli 23 (Gjyqësor dhe të Drejta Themelore) kërkon shfaqje të qëndrueshme rezultatesh matëse dhe jo vetëm ligje formale.

Sfida kryesore

- ▶ CPI = 39 — ndër më të ulët kandidatëve
- ▶ SPAK i mbingarkuar me kapacitet të pamjaftueshëm
- ▶ E-Procurement vetëm 60% i prokurimeve — gap i madh
- ▶ IMH 26%: 1 nga 4 lekë publike humbet efektivitetin
- ▶ Emigracioni i profesionistëve: korrelacion i fortë me CPI

Mundësi dhe hapësirat

- ▶ SPAK i forcuar: zgjerim 40% kapaciteti hetimor
- ▶ E-Procurement 100%: model rajonit me BCR 1:45
- ▶ Dixhitalizim fiskal: ulje evazion nën 0.4% GDP
- ▶ Target CPI 50–55 deri 2030: konvergjençë BE
- ▶ Raportim vjetor publik i koston: llogaridhënie

Burimet kryesore

MFE — Buxheti i Zbatuar 2025 | INSTAT — Llogaritë Kombëtare | Banka e Shqipërisë | IMF WEO October 2025 | World Bank WB6 RER 2025 | EBRD Transition Report 2025 | Transparency International CPI 2025 | IMF (2016) SDN/16/05 | Ugur & Dasgupta (2011) | OECD (2021) | SPAK Raportet 2024–25

www.altax.al

nfo@altax.al

Tiranë, Shqipëri | Maj 2026